

21-25
p. 117

RUBRIKA I

E DREJTA KUSHTETUESE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Teza 9

I. Rrethoni alternativën e saktë:

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në:

- a) Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së;
- c) Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së;
- d) Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore të OKB-së.

2. Parimi i proporcionalitetit ka të bëjë me:

- a) zbatimin e përpiktë të legjislacionit në fuqi;
- b) përdorimin e mjeteve të përshtatshme dhe në balancë me qëllimet që synohen të arrihen;
- c) realizimin në mënyrë efektive të së drejtës;
- d) trajtimin e barabartë të të gjitha subjekteve para ligjit.

3. Mund t'i bëjë kërkesë Gjykatës Kushtetuese për ta vënë në lëvizje jo vetëm për çështje që lidhen me interesit e tij:

- a) Avokati i Popullit;
- b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- c) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- d) Organi i qeverisjes vendore.

4. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga:

- a) Kryetari i Kuvendit;
- b) nga Presidenti i Republikës;
- c) nga Kryeministri;
- d) jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit.

5. Akti me fuqinë e ligjit i nxjerrë nga Këshilli i Ministrave hyn në fuqi:

- a) menjëherë;
- b) pasi miratohet në Kuvend;
- c) pasi botohet në Fletoren Zyrtare;
- d) jo më parë se 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



6. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për kryerjen e një vepre penale;
- b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer nga pakujdesia;
- c) ai merr cilësinë e të pandehurit për kryerjen e një kundërvajtje penale;
- d) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

7. Ligji i miratuar nga Kuvendi, i cili as nuk shpallet dhe as nuk kthehet për rishqyrtim nga Presidenti i Republikës brenda 20 ditëve:

- a) nuk hyn në fuqi;
- b) konsiderohet i shpallur;
- c) konsiderohet i pezulluar;
- d) konsiderohet se ka humbur fuqinë që nga miratimi.

8. Shpallja e gjendjes së luftës në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë bëhet nga:

- a) Kuvendi me kërkesë të Presidentit të Republikës;
- b) Presidenti i Republikës, me kërkesë të Këshillit të Ministrave;
- c) Kuvendi me kërkesë të Këshillit të Ministrave;
- d) Presidenti i Republikës, me kërkesë të Kryeministrit.

9. Për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në:

- a) pesë votime;
- b) katër votime;
- c) tre votime;
- d) dy votime.

10. Ka fuqi normative juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Shqipërisë, në kohë paqe:

- a) urdhri i Kryeministrit;
- b) rregullorja e Kuvendit;
- c) dekreti i Presidentit të Republikës;
- d) udhëzimi i ministrit.



RUBRIKA II

E DREJTË ADMINISTRATIVE – E DREJTË PUNE

TEZA 2

I. Gjени përgjigjen e saktë:

E DREJTË ADMINISTRATIVE

- 11. Klasifikimi i organeve shtetërore në organe të përgjithshme dhe në organe të posaçme bëhet për shkak të:**
- kriterit të përbërjes;
 - rolit që luajnë;
 - kriterit të kompetencave;
 - kriterit të shtrirjes territoriale.
- 12. Në qoftë se kërkesa për fillimin e procedurës administrative nuk është paraqitur tek organi kompetent i ngarkuar me ligj për shqyrtimin e saj, ky i fundit:**
- ia kthen kërkuetit për ta paraqitur tek organi kompetent;
 - ia përcjell kërkesën menjëherë organit publik kompetent dhe njofton kërkuetin për këtë;
 - vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të tij;
 - e konsideron të pabazuar dhe e arkivon çështjen.
- 13. Institucionet e pavarura, sipas kuptimit të ligjit që rregullon shërbimin civil:**
- nuk e organizojnë vetë marrjen në punë të nëpunësve të tyre civilë;
 - nuk kanë detyrimin të respektojnë aktet nënligjore, të nxjerrë në zbatim të ligjit “Për nëpunësin civil”;
 - duhet të krijojnë Drejtorinë e Personelit që të merret me rekrutimin e nëpunësve civilë;
 - janë të varura nga Departamenti i Administratës Publike për rekrutimin e nëpunësve civilë.
- 14. Lidhur me rivendosjen në afat sipas Kodit të Procedurave Administrative:**
- Organi para të cilit është paraqitur kërkesa për rivendosjen në afat merr vendim brenda 30 ditëve.
 - Depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit.
 - Kundër vendimit të organit publik për mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat nuk lejohet ankim i veçantë.
 - Pranimi i kërkesës për rivendosjen në afat nuk anulon veprimet procedurale, të kryera si pasojë e humbjes së afatit.
- 15. Padia kundër aktit nënligjor normativ duhet të paraqitet në gjykatën administrative brenda:**
- 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit normativ;
 - një muaji nga dita e botimit në Fletoren Zyrtare;
 - 30 ditëve nga data e njoftimit të subjektit të interesuar;
 - 2 vjetëve nga marrja dijeni për përmbajtjen e aktit.



16. Sipas nenit 12 të LGJA-së, çështjet për zhvillimin e praktikës gjyqësore në Gjykatën e Lartë gjykohen:

- a) Me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar;
- b) Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë;
- c) Me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë;
- d) Nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

17. Në rastet kur gjyqtari administrativ konstaton në veprimet përgatitore se, sipas LGJA-së, nuk plotësohet një nga kushtet formale të padisë (afati, legjitimimi, shterimi i ankimit administrativ) vendos:

- a) kthimin e padisë për plotësim;
- b) mospranimin e padisë;
- c) pushimin e gjykimit;
- d) rrëzimin e padisë.

E DREJTË PUNE

18. Zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme:

- a) kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë;
- b) për shkak të pjesëmarrjes së punëmarrësit në veprimtari sindikale në përputhje me ligjin;
- c) kur punëmarrësi ka refuzuar kryerjen e një detyre tjetër të ngarkuar nga punëdhënësi të parashikuar në përshkrimin e punës te kontrata e punës;
- d) punëmarrësi ushtron një të drejtë kushtetuese.

19. Nëse punëmarrësi nuk e kryen punën zakonisht në të njëjtin shtet, por tërësia e rrethanave për kryerjen e saj tregojnë lidhje të ngushta me një shtet të caktuar, kontrata e punës rregullohet nga:

- a) ligji shqiptar i punës;
- b) ligji i shtetit në të cilin punëmarrësi kryen më së shumti punën/detyrat e tij;
- c) ligji i shtetit me të cilin kontrata e punës paraqet lidhje më të ngushta;
- d) ligji ku ndodhet qendra e punëdhënësit.

20. Organizata profesionale e fiton personalitetin juridik:

- a) pas 30 ditëve nga dorëzimi i statutit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë;
- b) pas 30 ditëve nga vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për regjistrimin e saj;
- c) pas 60 ditëve nga dorëzimi i statutit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë;
- d) pas 60 ditëve nga vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për regjistrimin e saj.



RUBRIKA III
E DREJTË PENALE – PROCEDURË PENALE
TEZA 8

I. Rrethoni alternativën e saktë:

E DREJTË PENALE

- 21. Vrasja me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme karakterizohet nga:**
- a) Kryerja e veprës penale duke u nxitur nga veprimet provokuese të viktimës;
 - b) Kryerja e veprës penale pas mbrojtjes, kur sulmi i padrejtë nga ana e viktimës kishte kohë që kishte përfunduar;
 - c) Kryerja e veprës penale edhe kur autori e ka provokuar fillimisht viktimën;
 - d) Kryerja e veprës penale për të shmangur një sulm të padrejtë, të çastit dhe të vërtetë, ku karakteri i mbrojtjes është në kapërcim të kufijve të mbrojtjes.
- 22. Në veprën penale të fillimit të paligjshëm të ndjekjes penale, a është oficeri i policisë gjyqësore subjekt i saj?**
- a) Oficeri i policisë gjyqësore është subjekt i kësaj vepre penale;
 - b) Gjyqtari i seancës paraprake është subjekt i veprës;
 - c) Prokurori është subjekt i veprës penale, sepse ai është kompetent për të filluar ndjekjen penale;
 - d) Oficeri i policisë gjyqësore ndjek penalisht me iniciativën e vet me të konstatuar kryerjen e një vepre penale.
- 23. Nëse një person kryen një vrasje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës, a do të akuzohet ai edhe për vrasje me paramendim për shkak se ka vepruar përmbi një plan paraprak?**
- a) Vrasja për shkak të cilësive të veçanta të viktimës është vepër e cilësuar më e rrezikshme dhe, nuk konkurren me vrasjen me paramendim;
 - b) Ajo konkurren me vrasjen me paramendim nëse shkalla e paramendimit është aq e lartë sa tregon një masë të madhe profesionale që përbën rrezik përtej cilësive të veçanta të viktimës;
 - c) Në këtë rast gjithmonë gjykata do të cilësojë veprën si e kryer me paramendim;
 - d) Në këtë rast do të kemi konkurrencë të veprave dhe personi do të akuzohet sipas dy dispozitave përkatëse penale.
- 24. Dënimi i një personi për shkak të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale kërkon që:**
- a) Organizata të ketë kryer së paku një vepër penale në kuadër të kësaj forme të veçantë bashkëpunimi;
 - b) Vërtetimin e ekzistencës së saj dhe anëtarësinë e këtij personi, edhe nëse nuk provohet kryerja e ndonjë vepre penale nga organizata kriminale;
 - c) Personi të ketë dijeni për të gjithë pjesëtarët e organizatës kriminale;
 - d) Personi të ketë kryer së paku një vepër penale tjetër, veç pjesëmarrjes në të, në kuadër të organizatës kriminale të krijuar më parë.



25. Vepra penale të përbëra quhen:

- a) Veprat penale që cenojnë njëkohësisht dy apo më shumë marrëdhënie juridike të mbrojtura nga ligji penal;
- b) Veprat penale të cilat formohen nga dy vepra të tjera penale, të cilat mund të qëndrojnë edhe veçmas si vepra penale të posaçme;
- c) Veprat penale që kryhen me dy ose më shumë veprime, të cilat po të shkëputen nga njëra-tjetra formojnë figurën e të njëjtës vepër penale;
- d) Veprat penale të cilat kryhen nga shumë persona njëkohësisht.

PROCEDURË PENALE

26. Në rastin e marrjes në pyetje të personit, pasi ndaj tij është vendosur dhe ekzekutuar masa e sigurimit “ndalim për dalje jashtë shtetit”, marrja në pyetje nga gjykata duhet të kryhet:

- a) brenda afatit prej 72 orësh;
- b) brenda 3 ditëve nga zbatimi i masës;
- c) brenda 5 ditëve nga zbatimi i masës;
- d) ligji nuk parashikon kryerjen e këtij veprimi.

27. Procesverbali i mbajtur me shtypshkrim është i pavlefshëm:

- a) kur ka dyshime për identitetin e personave që kanë marrë pjesë;
- b) kur mungon nënshkrimi i personave që janë cituar si të pranishëm në procesverbal;
- c) kur mungon nënshkrimi i mbrojtësit të të pandehurit, në rast se ai ka qenë i pranishëm;
- d) kur mungon data e procesverbalit.

28. Lidhur me moskompetencën lëndore është i vërtetë pohimi:

- a) Në asnjë rast nuk mund të ngrihet edhe kryesisht;
- b) Mund të ngrihet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit;
- c) Mund të ngrihet ose të kundërshtohet vetëm në seancën paraprake;
- d) Për ngritjen e saj ligji cakton afate që nuk mund të zgjaten.

29. Lidhur me njoftimin e të pandehurit të burgosur është i vërtetë pohimi:

- a) Bëhet në vendin ku vuan dënimin duke i dorëzuar atij personalisht aktin;
- b) Bëhet në vendin ku vuan dënimin duke i dorëzuar aktin drejtuesit të institucionit;
- c) Mjafton që akti t'i dorëzohet mbrojtësit ose familjarëve të tij;
- d) Secila nga format e mësipërme të njoftimit është e vlefshme.

30. Kur gjatë seancës paraprake, në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal, atëherë gjykata:

- a) vendos dërgimin e çështjes në gjyq, duke përfshirë edhe akuzën për këtë fakt;
- b) në çdo rast i kthen aktet prokurorit për akuzën e re;
- c) lejon komunikimin e akuzës për këtë fakt, kur e kërkon prokurori dhe i pandehuri bie dakord;
- d) fton prokurorin të bëjë saktësimin e akuzës.



RUBRIKA IV
PROCEDURË CIVILE DHE E DREJTË CIVILE
TEZA 17

I. Rrethoni alternativën e saktë:

PROCEDURË CIVILE

31. Gjeni fjalinë e saktë:

- a) Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë që shpall kompetencën për gjykimin e çështjes, është vendim jopërfundimtar;
- b) Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë që pranon se ka juridiksion për gjykimin e çështjes, është vendim jopërfundimtar;
- c) Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë që shpall moskompetencën për gjykimin e çështjes, është vendim përfundimtar;
- d) Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë që pranon se ka kompetencë për gjykimin e çështjes, është vendim i ndërmjetëm.

32. Gjeni fjalinë e saktë:

- a) Vendimi i gjykatës për kthimin e kërkesëpadisë për shkak të mosndreqjes së të metave në afatin e caktuar nga gjykata, mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit brenda 5 ditëve;
- b) Vendimi i gjykatës për kthimin e kërkesëpadisë për shkak të mosndreqjes së të metave në afatin a caktuar nga gjykata, mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit brenda 15 ditëve;
- c) Vendimi i gjykatës për kthimin e kërkesëpadisë për shkak të mosndreqjes së të metave në afatin e caktuar nga gjykata, nuk mund të ankimohet;
- d) Ankimi kundër vendimit për kthimin e kërkesëpadisë për shkak të mosndreqjes së të metave në afatin e caktuar nga gjykata, fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

33. Gjeni fjalinë e saktë:

- a) Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë, vetëm me një nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit të parashikuara shprehimisht në ligj, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme, jo më të madhe se atë të padisë;
- b) Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë, vetëm me një nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, të parashikuara shprehimisht në ligj, me një shumë të përgjithshme më të madhe se atë të padisë;
- c) Gjykata në asnjë rast nuk mund të vendosë më shumë se një masë sigurimi të padisë;
- d) Gjykata nuk mund të lejojë sigurimin e padisë vetëm për një pjesë të objektit të saj, në asnjë rast.



34. Gjени fjalinë e saktë:

- a) Gjykata mund të kërkojë të dhëna me shkrim, për akte dhe dokumente që ndodhen në organet e administratës shtetërore që përbëjnë sekret shtetëror, pa pasur nevojë të kërkojë leje nga organi qendror nga i cili varet organi administrativ;
- b) Gjykata duhet të kërkojë të dhëna me shkrim, për akte dhe dokumente që ndodhen në organet e administratës shtetërore që përbëjnë sekret shtetëror;
- c) Gjykata duhet të kërkojë të dhëna me shkrim, për akte dhe dokumente që ndodhen në organet e administratës shtetërore që nuk përbëjnë sekret shtetëror, në çdo rast që kërkohet nga një palë;
- d) Gjykata mund të kërkojë të dhëna me shkrim, për akte dhe dokumente që ndodhen në organet e administratës shtetërore edhe nëse përbëjnë sekret shtetëror, duke marrë më parë lejen e organit qendror nga i cili varet organi administrativ.

35. Gjени fjalinë e saktë:

- a) Nëse vendimi i shpallur nga Gjykata e Lartë përmban gabime materiale apo në përlllogaritje, pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë korrigjimin apo ndreqjen e tyre në çdo kohë;
- b) Gabimet materiale në arsyetimin e vendimit përbëjnë shkak për cenimin e vendimit edhe kur zgjidhja në themel është e drejtë;
- c) Nëse vendimi i shpallur nga Gjykata e Lartë përmban gabime materiale apo në përlllogaritje, pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë me kërkesë korrigjimin apo ndreqjen e tyre brenda 60 ditëve nga njoftimi i vendimit
- d) Shqyrtimi i kërkesës për ndreqjen e gabimeve materiale apo në përlllogaritje, bëhet në dhomë këshillimi me prezencën e palëve nga një trup gjykues i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin.

E DREJTË CIVILE

36. Cilat janë rregullat për vendqëndrimin në Kodin Civil?

- a) Nuk quhet vendqëndrim vendi ku personi qëndron për t'u mjekuar.
- b) Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kaluar pushimet e tij verore.
- c) Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë, për të ndjekur një kurs etj.
- d) Nuk quhet vendqëndrim vendi ku personi qëndron për të vuajtur një dënim penal.

37. Cila është natyra e kontratës së nënenfiteozës:

- a) Kontrata e nënenfiteozës nuk lejohet të lidhet.
- b) Nënenfiteoza mund të lidhet vetëm me pëlqimin me shkrim të pronarit të sendit.
- c) Kontrata e nënenfiteozës është e paligjshme, nëse lidhet.
- d) Nënenfiteoza dhe nënqiraja kanë natyrë të njëjtë dhe mund të lidhen vetëm me pëlqimin me shkrim të pronarit të sendit.



38. Cila është përgjegjësia për dëmin e personit që nuk e ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimit që kryen:

- a) Për dëmin nuk përgjigjet personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij.
- b) Për dëmin përgjigjet edhe personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij.
- c) Personi që në momentin që e ka shkaktuar dëmin, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij ka përgjegjësi solidare me kujdestarin e tij.
- d) Për dëmin e shkaktuar nga personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij përgjigjet kujdestari i tij.

39. Kur ndërpritet parashkrimi?

- a) me çdo veprim të personit fizik ose juridik që e kërkon në mënyrë të shprehur këtë ndërprerje;
- b) me paraqitjen e padisë, të kundërpadisë ose të prapësimit, qoftë edhe në një gjykatë që nuk është kompetente nga pikëpamja tokësore ose lëndore.
- c) me pëlqim të përbashkët të debitorit dhe kreditorit të shprehur deklarata noteriale që ka si objekt ndërprerjen e parashkrimit;
- d) në rastin e një force madhore që i pengon palët në mënyrë objektive në përmbushjen e detyrimeve.

40. Kur çelet trashëgimia?

- a) Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën e fundit pas të cilës nuk ka më lajme nga personi i zhdukur.
- b) Trashëgimia çelet kur trashëgimtari i drejtohet noterit me kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.
- c) Trashëgimia çelet kur noteri lëshon dëshminë e trashëgimisë.
- d) Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi.



RUBRIKA V

E DREJTA FAMILJARE DHE E DREJTA TREGTARE

TEZA 11

Rrethoni alternativën e saktë:

E DREJTA FAMILJARE

41. Pakësimi ose heqja e detyrimit për ushqim fillon:

- a) nga dita e ngritjes së kërkesëpadisë;
- b) nga dita kur kanë ndryshuar rrethanat;
- c) nga dita që vendimi merr formë të prerë;
- d) rast pas rasti në vlerësim të gjykatës.

42. Nëse veprimi juridik, për të cilin është i nevojshëm pëlqimi i të dy bashkëshortëve, është kryer nga njëri bashkëshort pa autorizim gjykatë, sipas Kodit të Familjes, bashkëshorti tjetër:

- a) mund të kërkojë pavlefshmërinë e veprimit juridik brenda një viti nga marrja dijeni;
- b) mund të kërkojë që veprimi të mos sjellë asnjë detyrim për të;
- c) mund të kërkojë sipas rastit pavlefshmërinë ose mosnjohjen e veprimit;
- d) do të konsiderohet debitor solidar.

43. Në rastin e shkeljes së besnikërisë bashkëshortore:

- a) Bashkëshorti mund të kërkojë shpërblim dëmi bashkë me zgjidhjen e martesës;
- b) Bashkëshorti mund të kërkojë shpërblim dëmi edhe pa kërkuar zgjidhjen e martesës;
- c) Shpërblimi i dëmit mund të kërkojë ndaj personit të tretë;
- d) Shkelja e besnikërisë bashkëshortore nuk lidhet me shpërblimin e dëmit.

44. Të drejtën për të bërë kërkesën për shpalljen e martesës e kanë:

- a) Noteri;
- b) Prindërit e të miturit që kërkon të lidhë martesë nën moshë;
- c) Bashkëshortët e ardhshëm;
- d) Nëpunësi i gjendjes civile.

45. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes mund të parashikohen masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje:

- a) edhe nga gjykata kryesisht;
- b) vetëm kur kërkojë nga personi që përfaqëson fëmijën e mitur;
- c) vetëm kur e kërkon viktima e dhunës;
- d) vetëm kur e kërkon prokurori.



E DREJTA TREGTARE

46. Prishja e shoqërisë kolektive ka si shkak:

- a) hapjen e procedurave të falimentimit ndaj një ortaku;
- b) vdekjen e një ortaku;
- c) njoftimi i një ose disa ortakëve për largim nga shoqëria;
- d) mbarimin e kohëzgjatjes, për të cilën është themeluar.

47. Veprimtaria tregtare e një shoqërie komandite administrohet nga:

- a) një ose më shumë ortakë të pakufizuar;
- b) një ose më shumë ortakë të kufizuar;
- c) nga ortakët e kufizuar e të pakufizuar së bashku;
- d) nga të gjithë ortakët e pakufizuar bashkërisht.

48. Veprimet e SHPK-së, ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj:

- a) nëse veprimi i drejtohet të gjithë zotëruesve të kuotës;
- b) nëse i drejtohet shumicës së tyre;
- c) nëse i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve;
- d) nëse i drejtohet shumicës së ortakëve të tjerë.

49. Këshilli i Administrimit në një SHA përbëhet nga:

- a) të paktën 3 anëtarë;
- b) të paktën 3 anëtarë, por jo më shumë se 21 anëtarë;
- c) jo më shumë se 21 anëtarë;
- d) persona juridikë dhe fizikë, pavarësisht nga numri.

50. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe:

- a) kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë;
- b) nuk kanë të njëjtin personalitet me shoqërinë;
- c) nuk organizohen dhe administrohen më vete;
- d) nuk ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.



RUBRIKA VI
E DREJTA E BE-SË
E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

TEZA 2

LEGJISLACIONI I BE-së

51. Sipas parimit të Subsidiaritetit:

- a) Bashkimi vepron vetëm brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë nga Shtetet Anëtare.
- b) Në fushat që nuk bien në kompetencë të tij ekskluzive, Bashkimi vepron vetëm nëse dhe për aq sa objektivat e veprimit të propozuar nuk mund të arrihen në masë të mjaftueshme nga Shtetet Anëtarë dhe BE ka mjete më efektive të rregullimit.
- c) Përmbajtja dhe forma e veprimit të Bashkimit nuk duhet të tejkalojë atë që është e nevojshme për të arritur objektivat e Traktateve.
- d) Asnjë prej përgjigjeve të mësipërme.

52. Akti i Vetëm (Unik) European ishte një pikë kthese për integrimin në BE, sepse:

- a) Përgatiti reformën për përfundimin e tregut të brendshëm;
- b) Përforcoi rolin e Këshillit European;
- c) Paraqiti shtyllat e politikave të Bashkëpunimit në Drejtësi dhe Punët e Brendshme;
- d) Parashikoi masat për lëvizjen e lirë.

53. Anëtarët e Parlamentit European:

- a) duhet të jenë anëtarë të një parlamenti kombëtar;
- b) ndjekin direktiva për çështje të caktuara, nga shtetet e tyre, anëtare;
- c) zgjidhen për një mandat prej 5 vitesh, me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë;
- d) caktohen në përpjesëtim të drejtë me numrin e anëtarëve të parlamentit kombëtar.

54. Njëpërmjet procedurës paragjykimore, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European shprehet lidhur me:

- a) Interpretimin e traktateve dhe vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit European;
- b) Përputhshmërinë e legjislacionit të shteteve anëtare me *acquis* e Bashkimit European;
- c) Përputhshmërinë e marrëveshjeve që lidhin shtetet anëtare me palë të treta;
- d) a+b.

55. Aktet e legjislacionit dytësor të BE-së, të cilat nuk kanë fuqi detyruese janë:

- a) Vendimet;
- b) Direktivat;



- c) Rekomandimet dhe opinionet;
- d) Rregulloret.

E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

56. Në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë mund të kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në rrugë gjyqësore:

- a) Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit;
- b) Vetëm shtetet që janë palë në mosmarrëveshje;
- c) Organizatat ndërkombëtare dhe shtetet;
- d) Këshilli Ekonomik dhe Social dhe Këshilli i Sigurimit.

57. Nuk është kriter për fitimin e shtetësisë shqiptare:

- a) Personi të ketë banesë në përputhje me standardet e miratuara të banimit në RSH;
- b) Personi të ketë qëndruar në mënyrë të vazhdueshme në RSH së paku 7 vjet;
- c) Personi të ketë njohuri të kushtetutës shqiptare;
- d) Asnjëra prej tyre.

58. Kërkesa për Mendim Këshillimor në çështjen e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës u paraqit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë nga:

- a) Serbia;
- b) Këshilli i Sigurimit të OKB-së;
- c) Asambleja e Përgjithshme e OKB-së;
- d) KFOR.

59. Bashkimi real formohet si rezultat i:

- a) marrëveshjes midis shteteve;
- b) okupimit real;
- c) trashëgimit të kurorës mbretërore;
- d) a + b.

60. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk e shqyrtoi themelin e çështjes së Arit Monetar, me argumentin se:

- a) çështja ishte paraqitur jashtë afatit;
- b) nuk kishte juridiksion, pasi Shqipëria nuk kishte dhënë pëlqimin e saj;
- c) çështja konsiderohej përfundimisht e zgjidhur me dhënien e dëmshpërblimit Mbretërisë së Bashkuar, për Incidentin e Kanalit të Korfuzit;
- d) çështja konsiderohej përfundimisht e zgjidhur nga Komisioni Trepalësh.



RUBRIKA VII

HISTORIA E SË DREJTËS NË SHQIPËRI

Teza 5

Rrethoni pohimin e saktë:

61. Gjatë mesjetës, në Arbëri, kanë vepruar:

- a) E drejta pozitive (e krijuar/sanksionuar nga pushteti shtetëror);
- b) E drejta kanonike (e ritit katolik dhe ortodoks);
- c) E drejta zakonore;
- d) E drejta pozitive, e drejta kanonike, e drejta zakonore, paralelisht.

62. Gjatë mesjetës, në Arbëri, 'e drejta e veçantë', ekzistonte krahas, dhe në kuadër të së drejtës:

- a) pozitive;
- b) kanonike;
- c) zakonore;
- d) kanoniko-zakonore.

63. Sipas Statuteve të Shkodrës:

- a) Trupi gjykues përbëhej nga tre anëtarë;
- b) Përbërja e trupit gjykues nuk mund të kundërshtohet nga palët;
- c) Afatet e gjykimit dhe të shpalljes së vendimit ishin të shkurtra – 15 ditë ose më pak;
- d) Gjykatësit nuk ishin të pranishëm në praninë e organeve komunale.

64. Në Lidhjen e Lezhës:

- a) Pozita juridike e Skënderbeut ishte ajo e një monarku;
- b) Bujarët feudalë ruajtën të drejtën të hynin në marrëdhënie ndërkombëtare në mënyrë të pavarur;
- c) Bujarët feudalë nuk mund të hynin në marrëdhënie ndërkombëtare në mënyrë të pavarur, pa miratimin e Lidhjes;
- d) Nuk lejohej largimi i princave pa miratimin e Skënderbeut e gjithë anëtarëve të tjerë të Lidhjes.

65. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- a) Pashallëku i Janinës nën sundimin e Ali Pashë Tepelenës kishte popullsi të kombësive dhe besimeve fetare të ndryshme, të cilët shërbenin edhe në administratë;
- b) Pushteti i Ali Pashë Tepelenës ishte origjinal dhe i pa deleguar nga Porta e Lartë;
- c) Ali Pashë Tepelena nuk mbështeste ushtarakisht Portën e Lartë në fushata ushtarake kur kërkohej;



- d) Në krye të pushtetit të Pashallëkut të Janinës ka qenë 'divani' – organ me attribute ekzekutive.

66. Kusht i bashkëpunimit dhe ndihmës së Ali Pashë Tepelenës në marrëdhënie me rusët, francezët dhe anglezët ishte:

- a) Bashkimi me Pashallëkun e Shkodrës;
- b) Ndihma në fushën ushtarake në rast sulmi nga jashtë;
- c) Njohja e tij si sovran i Epirit dhe si sundimtar i qyteteve shqiptare të bregdetit;
- d) Ndihma financiare dhe ekonomike për mbulimin e fushatave ushtarake.

67. Statuti Organik i Shqipërisë (1914):

- a) Nuk rregullonte pozitën juridiko-kushtetuese të vendit;
- b) Vlerësohet si një kushtetutë europiane për Shqipërinë;
- c) Nuk e parashikonte Shqipërinë si principatë sovraane;
- d) Copëzonte vendin duke parashikuar se Shqipëria ishte e ndashme.

68. Sipas Statutit Organik të Shqipërisë:

- a) Shtetas shqiptarë ishin të gjithë ata të lindur ose vendosur në Shqipëri para datës 28.12.1912;
- b) Gjuha zyrtare ishte gjuha shqipe dhe përdorimi i gjuhëve të tjera që fliteshin në vend nuk lejohej;
- c) Protokollin e Korfuzit ishte në përputhje të plotë me të;
- d) Neutraliteti i Shqipërisë nuk parashikohej në asnjë dispozitë.

69. Cili nga kriteret e mëposhtme parashikohej në Statutin Themeltar të Republikës së Shqipërisë si pengesë për kurorëzimin e Ahmet Zogut si mbret?

- a) Mungesa e origjinës mbretërore;
- b) Forma e shtetit nuk mund të ndërrohej;
- c) Mungesa e origjinës mbretërore dhe se forma e shtetit nuk mund të ndërrohej;
- d) Mungesa e njohjes nga Italia, Britania e Madhe dhe fuqitë e tjera të mëdha.

70. Artikulli 1 i Statutit Themeltar sipas miratimit të Asamblesë Kushtetuese (më 1928), e shpalli Shqipërinë:

- a) Mbretëri demokratike;
- b) Mbretëri demokratike parlamentare;
- c) Mbretëri demokratike parlamentare të trashëgueshme;
- d) Mbretëri të trashëgueshme.



RUBRIKA VIII
GJUHA SHQIPE
TEZA 20

71. Gjeni fjalën e futur gabim në grupin e fjalëve të përngjitura:

- a) Megjithatë;
- b) Bashkëbisedoj;
- c) Njëmbëdhjetë;
- d) Faleminderit.

72. Qarkoni rasën në të cilën është emri i nënvizuar: “Fletë ke ti, fletë kam edhe unë, gjemba ti, gjemba edhe unë”.

- a) Rasa emërore;
- b) Rasa dhanore;
- c) Rasa kallëzore;
- d) Rasa rrjedhore.

73. Në ndërtimin “Ju ika, ju ika”, fjala “ju” është:

- a) Përemër vetor;
- b) Përemër dëftor;
- c) Pjesëz;
- d) Trajta e shkurtër e përemrit vetor.

74. Grupi emëror përmban:

- a) Emër + folje;
- b) Emër + mbiemër;
- c) Përemër + mbiemër;
- d) Numëror + emër + folje.

75. Nga pikëpamja kuptimore kallëzuesi tregon:

- a) Atë që kryen veprimin;
- b) Objektin e veprimit;
- c) Veprimin që kryen kryefjala;
- d) Atë që pëson veprimin.



76. Mbiemrat: botëror; paqësor, shembullor janë:

- a) Të parmë;
- b) Të prejardhur;
- c) Të përbërë;
- d) Të përngjitur.

77. Sa fjali të përbëra ndodhen në materialin e mëposhtëm?

“E drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe. Të heqësh dorë nga e drejta mbi sendet e mësipërme, nuk të liron nga detyrimi për të kontribuar në shpenzime.”

- a) 1;
- b) 2;
- c) 3;
- d) 4.

78. Fjalët e nënvizuara te fjalia e mëposhtme, kryejnë funksionin e:

“Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe madje zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.”

- a) Kryefjalës;
- b) Rrethanorit;
- c) Kundrinorit;
- d) Kallëzuesit.

79. Fjala e nënvizuar te fjalia: “Luftëtar i hijshëm, fisnik dhe madhështor.” është:

- a) Folje;
- b) Mbiemër i nyjshëm;
- c) Mbiemër i panyjshëm;
- d) Ndajfolje.

80. Sa fjalë mohuese ka në fjalinë: “Ai nuk u trondit aspak nga vendimi që mori Gjykata e Strasburgut.”.

- a) 1;
- b) 2;
- c) 3;
- d) 4.



RUBRIKA IX
TESTI I INTELIGJENCËS

Teza 5

I. Rrethoni alternativën e saktë:

81. Cili numër duhet të vijë në radhë në këtë seri numrash: 6, 10, 13, 14, 18, 21, 22, ?

- a) 25;
- b) 24;
- c) 26;
- d) 23.

82. Në një garë gjysmë maratonë në Tiranë, Besarta doli përpara Edonës. Besarta mbaroi pas Manjolës. Albana doli përpara Manjolës, por pas Rovenës. Në çfarë vendesh mbaruan respektivisht Besarta dhe Albana?

- a) E 5-ta dhe e 3-ta;
- b) E 4-ta dhe e 2-ta;
- c) E 2-ta dhe e 4-ta;
- d) E 2-ta dhe e 3-ta.

83. Cili është numri që mungon në këtë seri numrash: 22, 12, 10, 35, ?, 16, 34, 23, 11.


- a) 16;
- b) 19;
- c) 22;
- d) 24.

84. Në mishin e blejmë nga kasapi i lagjes. Ai përdor një peshore të vjetër me pesha të veçanta njësoj sikur ka vepruar gjyshi i tij. Ai ka vetëm 4 pesha dhe duke përdorur të dyja peshoret nëse është e nevojshme, ai mund të peshojë një numër të caktuar kilesh nga 1 kg deri në 40 kg. Cilat janë peshat që ka kasapi?

- a) 1kg, 3 kg, 9kg, 27kg;
- b) 2kg, 5kg, 13kg, 20kg;
- c) 1kg, 4kg, 8kg, 29kg;
- d) 3kg, 9kg, 12kg, 16kg.

85. Cili është numri që mungon në këtë seri numrash: 39, 32, ?, 18, 11.

- a) 21;
- b) 23;
- c) 25;
- d) 27.



86. Me cilin nga emrat e mëposhtëm lidhet fruti i Mollës?

- a) Darvini;
- b) Ajnshtajni;
- c) Platoni;
- d) Njutoni.

87. Një hetim i numrit të aksidenteve me makinë tregoi si më poshtë: 18 aksidente ishin shkaktuar nga alkooli dhe shpejtësia e madhe; 16 aksidente ishin shkaktuar nga alkooli; 12 aksidente ishin shkaktuar nga shpejtësia e madhe, por jo nga alkooli, dhe 21 aksidente nuk ishin shkaktuar as nga alkooli dhe as nga shpejtësia e madhe. Sa aksidente u hetuan gjithsej?

- a) 39;
- b) 67;
- c) 44;
- d) 31;
- e) 53.

88. Njëra nga fjalët nuk integrohet/përshtatet me tre të tjerat. Cila prej tyre?

- a) Gjueti;
- b) Këmbëz pushke;
- c) Qitje;
- d) Plumb.

89. Çfarë konkluzioni mund të nxirret nga teksti origjinal pa pasur asnjë informacion tjetër shtesë?

Policia vëren se një nga mjetet për të respektuar kufirin e shpejtësisë për shoferët ka qenë vendosja e pikave të kontrollit të radarëve në vende të përshtatshme.

- a) Kur shoferët vërejnë kontrollet me radar, ata e respektojnë kufirin e shpejtësisë.
- b) Një nga mjetet për respektimin e kufijve të shpejtësisë është kryerja e kontrolleve me radar.
- c) Problemi i respektimit të kufirit të shpejtësisë mund të zgjidhet duke instaluar mjaftueshëm në numër kontrolle me radar.
- d) Shoferët janë gjithnjë e më shumë të pakujdesshëm dhe nuk dinë të respektojnë kufijtë e shpejtësisë.
- e) Mënyra më e mirë për ta bërë një shofer të ndryshojë sjelljen e tij gjatë drejtimit të automjetit është që ai t'i nënshtrohet kontrolleve me radar.

90. Një tregtar bën llogaritë e përfundimit të javës. Ai ka shitur 20 këmisha me 200 euro, 50 kostume me 3.000 euro dhe 10 pallto me 4.000 euro. Cila është shuma që ky tregtar ka shitur mesatarisht për çdo klient duke supozuar se çdo klient ka blerë nga një artikull?

- a) 2.000;
- b) 2.425;
- c) 2.870;
- d) 3.125;
- e) 3.300.



RUBRIKA X
ETIKA PROFESIONALE
TEZA 10

I. Rrethoni alternativën e saktë:

91. Avokati ka të drejtë të reklamojë aktivitetin e tij:

- a) Mbi fushat e ligjit në të cilat ushtron aktivitetin;
- b) Mbi arsimimin juridik, formimin profesional dhe njohurive të gjuhëve të huaja;
- c) Mbi kohën e fillimit të aktivitetit dhe vendndodhjen e selisë;
- d) Të gjitha sa më sipër.

92. Në cilat raste gjyqtari mund të marrë dhurata, çmime, dekorime dhe tituj nderi:

- a) Me kushtin që këto të jepen nga Kryeministri;
- b) Me kushtin që këto të jepen nga Presidenti i Republikës;
- c) Me kushtin që këto të jepen nga ministri i Drejtësisë;
- d) Me kushtin që këto të jenë simbolike dhe të mos krijojnë dyshime të arsyeshme për njëanshmëri ose cenim të pavarësisë së gjyqtarit.

93. Prokurori X ka një rast vrasjeje ende të pazgjidhur. Atij i telefonon kolegu i tij, prokurori Y, duke i thënë se është mik i afërt i babait të të pandehurit në rastin e vrasjes që i është caktuar atij. I kërkon që të kujdeset që djali të ketë një hetim të drejtë. Gjithashtu, i thotë se nuk beson se dikush nga ajo familje mund të ketë kryer vrasjen. Cilin parim etik po shkel prokurori Y:

- a) Parimin e pavarësisë;
- b) Parimin e paanësisë;
- c) Parimin e pastërtisë së figurës;
- d) Parimin e respektit dhe aftësisë për të dëgjuar.

94. Në gjykatë, përpara gjyqtarit, ka ardhur momenti për të vendosur mbi përcaktimin e kujdestarisë së fëmijës gjatë periudhës së pushimeve verore, në një çështje të zgjidhjes së martesës pa pëlqimin reciprok të bashkëshortëve. I lodhur e mërzitur nga procedurat e tejzgjatura dhe ndërhyrjet e shumta, gjyqtari urdhëroi që çështja e kujdestarisë së fëmijës do të përcaktohej me hedhjen prej tij të një monedhe kokë a pil, gjë të cilën ai e bëri në sallën e gjyqit. Cilin nga parimet ka cenuar gjyqtari:

- a) Parimin e pavarësisë;
- b) Parimin e paanësisë;
- c) Parimin e transparencës;
- d) Parimin e trajtimit të barabartë.



95. Cili organ mbikëqyr zbatimin e rregullave etike gjyqësore:

- a) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b) Gjykata e Lartë;
- c) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- d) Ministri i Drejtësisë.

96. Në një qytet të vogël në jug ka pasur të shtëna me armë. Si rezultat i këtyre të shtënave katër persona kanë humbur jetën. Ky është rasti i parë në këtë qytet, ku një numër kaq i lartë i personave kanë humbur jetën. Banorët e qytetit janë të tronditur dhe duan informacione sa më të shpejta lidhur me rastin. Si duhet të veprojë prokurori në këtë rast:

- a) Prokurori përdor publikisht informacionin konfidencial për të cilin vihet në dijeni për shkak të detyrës;
- b) Prokurori jep intervistë në media mbi vrasjen e katër personave;
- c) Prokurori del në konferencë shtypi me gazetarët për rastin;
- d) Prokurori komunikon me prokurorin e medias të juridiksionit përkatës, duke shmangur çdo shfrytëzim të njohjeve personale me gazetarët.

97. Një palë e tretë që bën pagesën e punës së avokatit ka të drejtë të kërkojë informacion në lidhje me çështjen? Si duhet të silllet avokati në këtë rast:

- a) Informon një person të cilit ai është duke i deleguar detyrat individuale për shërbime ligjore mbi ecurinë e çështjes në fjalë, me kusht që edhe një person i tillë t'i nënshtrohet detyrimit të konfidencialitetit;
- b) Tregon konfidenca ose sekrete me pëlqimin e klientit ose të klientëve në fjalë, por vetëm pasi t'ua tregojë plotësisht atyre këtë gjë;
- c) Tregon konfidenca ose sekrete të nevojshme për të caktuar ose marrë pagesën e avokatit ose për të mbrojtur avokatin ose nëpunësit e tij ose ortakët kundër një akuze për sjellje të gabuar;
- d) Asnjëra prej tyre.

98. Prokurori X e ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë. Ndërkohë, në Vlorë e ushtron profesionin si avokat edhe Y. Të dy janë të një gjenerate, janë shkolluar bashkë dhe hapat e parë në fushën e drejtësisë i kanë bërë bashkërisht. Avokati Y ka shumë punë, mbron shumë të pandehur pikërisht në atë prokurori dhe gjykatë. Gjatë seancave të hetimit apo shqyrtimit gjyqësor, raportet e tyre janë shumë profesionale dhe asgjë nuk ndikon në vendimmarrjen e prokurorit X. Mirëpo, ata të dy çdo mbrëmje dalin së bashku, takohen në qendër të Skelës dhe ecin në Lungomare deri te "Hanover Bar", ku pasi pinë nga një kafe kthehen në këmbë për në shtëpitë e tyre. Këtë rutinë e përsërisin pothuajse çdo mbrëmje. A krijon kjo marrëdhënie dyshime për:

- a) Cenim të pavarësisë së prokurorit;
- b) Cenim të paanësisë së prokurorit;
- c) Cenim të pastërtisë së figurës së prokurorit;
- d) Asnjëra prej tyre.



99. Pas vendimmarrjes në një çështje kriminale të bujshme, avokati i të akuzuarit u shpreh në media se, gjyqtari vendosi padrejtësisht kundër marrjes së një dëshmie të rëndësishme për procesin dhe se publiku duhet ta dijë padrejtësinë që i ishte bërë të akuzuarit. Si mund të sillej etikisht avokati në këtë rast:

- a) Avokati duhet të sillet me respekt, ndershmëri dhe integritet kundrejt gjykatës në funksion të përfaqësimit e mbrojtjes së interesave të klientit të tij brenda kufijve të caktuar nga ligji dhe Kodi Etik;
- b) Avokati asnjëherë nuk duhet të kryejë sjellje që synojnë të prishin solemnitetin e gjykimit ose vetë gjykimin në themel të tij;
- c) Avokati nuk duhet të bëjë deklarata fyese ose përbuzëse për aktivitetin apo vendimet e gjykatave apo autoriteteve të tjera;
- d) Të gjitha sa më sipër.

100. Një prokuror në një debat televiziv, me emocione dhe me zë të lartë, ka kritikuar institucionet gjyqësore dhe gjykatësit në përgjithësi. Në mes të tjerave, ai theksoi se gjyqtarët janë joprofesionistë, dembelë dhe të korrumpuar. Sepse, nuk ka logjikë të shëndoshë ligjore, që gjyqtarët në shumicën e rasteve “peshqit e mëdhenj” akuzuar për veprat penale të korrupsionit, i rikualifikojnë për shpërdorim të detyrës zyrtare. Si mund të sillej etikisht prokurori në këtë rast:

- a) Prokurori nuk duhet të shprehë mosdakordësinë e tij mbi një vendim gjyqësor në shtyp;
- b) Prokurori nuk i komenton publikisht qëndrimet e tij në lidhje me çështjen, edhe nëse ato kritikohen nga media apo të tjerë;
- c) Prokurori nuk i komenton publikisht qëndrimet e tij në lidhje me çështjen, që nuk pranohen nga gjykata;
- d) Të gjitha sa më sipër.

